



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 29 tetor 2012  
Nr. ref.:VP318/12

## VENDIM PËR PRANUESHMËRI DHE SHTYRJE

në

Rastin KO63/12

**Kërkesa e Alma Lamës dhe e 10 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë deputetët e Kuvendit të Kosovës: Alma Lama, Visar Ymeri, Rexhep Selimi, Afrim Kasolli, Albulena Haxhiu, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Glauk Konjufca, Albin Kurti, Florin Krasniqi dhe Afrim Hoti.

## Objekti i çështjes

2. Kërkesa ka të bëjë me kushtetutshmërinë e neneve 37, 38 dhe 39 të **Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82** (në tekstin e mëtejme: Kodi Penal), të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 20 prill 2012, dhe të shpallur me vendim të Kuvendit më 22 qershor 2012.
3. Më saktësisht, parashtruesit e kërkesës i shtrojnë këtë pyetje Gjykatës Kushtetuese: “*A cenojnë nenet 37, 38, 39 të Kodit Nr. 04-L-082 Penal të Republikës së Kosovës të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Nenet 40 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me Nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj*”.

## Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 20 dhe 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## Procedura në Gjykatë

5. Më 29 qershor 2012, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.
6. Më 4 korrik 2012, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues, si dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.
7. Më 11 korrik 2012, Sekretariati i Gjykatës ua komunikoi kërkesën palëve të interesuara, përfshirë Presidenten e Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga; Kryetarin e Kuvendit të Republikës, z. Jakup Krasniqi; Kryeministrin e Qeverisë së Kosovës, z. Hashim Thaçi; dhe, Kryetarin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ismet Kabashi.
8. Të gjitha palët e interesuara u ftuan të bënin komente përkitazi me kërkesën, nëse kishin ndonjë koment, dhe t'i dërgonin ato në afatin pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e marrjes së njoftimit. Deri më sot, Gjykata nuk ka marrë ndonjë koment nga palët e interesuara.
9. Më 28 shtator 2012, parashtruesit e kërkesës kërkuan nga Gjykata që t'i informonte për statusin e rastit.
10. Më 5 tetor 2012, Gjykata i informoi parashtruesit e kërkesës se “*rasti është në procedurë shqyrtimi dhe se, së shpejti, do të informoheni me rezultatin e kërkesës suaj*”.
11. Më 18 tetor 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për pranueshmërinë e kërkesës dhe për shtyrjen e vendimit për meritat e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

12. Në bazë të procesverbalit nr. P-58 nga seanca plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 20 prillit 2012, Kuvendi i Kosovës, me 76 vota “për”, 9 vota “kundër”, dhe 1 “abstenim”, e miratoi Kodin Penal të Kosovës në leximin e dytë.
13. Kodi i miratuar Penal i përmbante nenet e kontestuara 37, 38 dhe 39, që rregullojnë përgjegjësinë penale për veprat penale të kryera me anë të medieeve.
14. Në këto dispozita thuhet:

### **“DISPOZITAT E POSAÇME MBI PËRGJEGJËSINË PENALE PËR VEPRAT PENALE TË KRYERA ME ANË TË MEDIAVE**

#### **Neni 37**

#### ***Përgjegjësia penale e kryeredaktorëve, botuesve, shtyp shkronjësve ose prodhuesve***

1. Autori i informacionit është penalisht përgjegjës nëse vepra penale është kryer perms publikimit të informatës në gazetë ose në lloj tjetër të shtypit periodik, radio, televizion, internet ose mjete tjera të komunikimit.
2. Kryeredaktori përgjegjës ose personi i cili e zëvendëson atë në kohën e publikimit të informatës është penalisht përgjegjës kur:
  - 2.1. autori nuk mund të gjendet apo të gjykohet në gjykatën e Kosovës;
  - 2.2. publikimi i informacionit është bërë pa dijeninë e autorit ose kundër vullnetit të tij; ose
  - 2.3. nëse gjatë kohës së publikimit të informatës kanë ekzistuar pengesa faktike dhe juridike për fillimin e procedurës penale ndaj autorit dhe të cilat ende ekzistojnë.
3. Kryeredaktori ose personi i cili e zëvendëson atë në kohën e publikimit të informatës nuk është penalisht përgjegjës nëse për shkaqe të arsyeshme nuk ka ditur për ndonjë rrethanë të paraparë në paragrafin 2. të këtij neni.
4. Botuesi i gazetës ose llojit tjetër të shtypit periodik është penalisht përgjegjës nëse kryeredaktori ose personi që e zëvendëson atë në kohën e publikimit të informatës në gazete ose llojin tjetër të shtypit periodik është penalisht përgjegjës sipas paragrafit 2. të këtij neni.
5. Kur botuesi është penalisht përgjegjës sipas paragrafit 4. të këtij neni dhe për shkak të pengesave juridike ose faktike nuk është e mundur të dënohet botuesi, atëherë personi i cili e ka shtypur informatën është penalisht përgjegjës nëse ai e ka ditur se pengesat e tilla ligjore ose faktike kanë ekzistuar.
6. Prodhuesi është penalisht përgjegjës kur kryeredaktori ose personi që e zëvendëson atë në kohën e publikimit të informatës me anë të shiritit manjetik, filmit, diapozitivave, fotografive ose pajisjeve tjera audio dhe video të dedikuara për mediat masive ose për prezantim publikut apo për një numër të madh të personave janë penalisht përgjegjës sipas paragrafit 2. të këtij neni.

7. Nëse botuesi, shtypshkronjësi ose prodhuesi i cili është penalisht përgjegjës sipas këtij neni është person juridik apo organ publik, personi përgjegjës për shtypjen ose aktivitetin prodhues është penalisht përgjegjës.

8. Personat e cekur në këtë nen nuk janë penalisht përgjegjës nëse publikimi i informatës është raport i saktë nga një mbledhje e organit publik ose nga deklarata e një personi zyrtar.

### **Neni 38** **Mbrojtja e burimit të informatës**

1. Personi i cili merr pjesë si profesionist në publikimin e informacionit ose si anëtar i bordit redaktues të mediave dhe ndihmësi i tij nuk janë penalisht përgjegjës nëse refuzojnë ta tregojnë autorin e publikimit ose burimin e informatës.

2. Personat e cekur në paragrafin 1. të këtij neni janë penalisht përgjegjës nëse gjykata konstaton se:

2.1. zbulimi i informatave është i domosdoshëm për të parandaluar sulmin që përbën kërcënim të pashmangshëm ndaj jetës apo integritetit trupor të ndonjë personi.

### **Neni 39** **Zbatimi i dispozitave të përgjithshme për përgjegjësinë penale**

Dispozitat për përgjegjësinë penale të personave të cekur në nenet 37 dhe 38 të këtij Kodi janë të zbatueshme vetëm nëse ata persona nuk janë penalisht përgjegjës sipas dispozitave të përgjithshme për përgjegjësinë penale të përcaktuar në këtë Kod.”

15. Sipas ueb-faqes së Presidentit të Republikës, më 4 maj 2012, Presidentja e Republikës, znj. Atifete Jahjaga, mori vendim që t’ia kthejë Kuvendit të Kosovës Kodin e miratuar Penal. Në këtë vendim thuhej: “Bazuar në kompetencat e Presidentes së Republikës së Kosovës, sipas nenit 84 pika 6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimi për rishqyrtimin e Kodit Penal u mor pasi u vlerësua se Neni 37 dhe Neni 38 i Kodit Penal janë në kundërshtim të plotë me Nenin 40 dhe Nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që rregullojnë lirinë e shprehjes dhe lirinë e medieve si dhe me Nenin 22, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës që obligon përmbushjen e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj”.
16. Mund të vërehet nga transkriptet e Kuvendit të Kosovës, të 22 qershorit 2012, se ishte diskutuar për shqyrtimin e “Vendimit të Presidentes së Republikës së Kosovës për ta kthyer Kodin Penal”. Po ashtu, mund të vërehet se Komisioni funksional propozoi miratimin e amendamentit të propozuar në Kodin Penal në pajtim me Vendimin e Presidentes për ta kthyer Kodin e miratuar Penal.
17. Në të vërtetë, Komisioni funksional kërkoi “të hiqeshin nenet 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal” dhe, në bazë të transkriptit të 22 qershorit 2012, votimi në Kuvend ishte ky: “59 vota për, katër vota kundër dhe 5 abstenime”.
18. Më tej, në transkriptin e 22 qershorit 2012, thuhej: “Në bazë të Rregullores, del se nuk janë bërë 61 vota dhe se nuk është krijuar shumica që të kalojë kërkesa e Presidentes,

*e cila ka kaluar nëpërmjet komisioneve. Dhe, në bazë të kësaj, ky ligj konsiderohet i shpallur”.*

19. Më 5 korrik 2012, Kuvendi mbajti leximin e parë të Projektligjit për Shfuqizimin e Neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal. Pas debatit, Kuvendi i Kosovës e miratoi ndryshimin e Kodit Penal, duke hequr nënën e kontestuar 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Kosovës.
20. Rrjedhimisht, Kuvendi i caktoi detyrë Komisionit për Legjislacion, që t’ia përgatisë Kuvendit Projektligjin dhe raportin për lexim të dytë, në një periudhë kohore dymuajshe, do të thotë deri më 5 shtator 2012.
21. Në ndërkohë, më 19 tetor 2012 Kuvendi mbajti leximin e dytë për Projektligjin për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal dhe miratoi Projektligjin.
22. Kodi Penal i Kosovës duhet të hyjë në fuqi më 1 janar 2013, siç është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 20 prill 2012, dhe i shpallur me vendimin e Kuvendit të 22 qershorit 2012.

### **Pretendimet e parashtruesve të kërkesës**

23. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se, më 22 qershor 2012, Kuvendi i Republikës e ka miratuar Kodin Penal të Republikës së Kosovës, që përmban nënën 37, 38 dhe 39, të cilat janë në kundërshtim me nënin 40 dhe 42 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe me nënin 10 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore (Konventa).
24. Në këto dispozita thuhet:

#### ***Neni 40 i Kushtetutës [Liria e Shprehjes]***

*1. Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.*

*2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.*

#### ***Neni 42 i Kushtetutës [Liria e Medieve]***

*1. Garantohej liria dhe pluralizmi i medieve.*

*2. Censura është e ndaluar. Askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet medieve, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.*

*3. Çdokush ka të drejtë të korrigjojë informacionin e pavërtetë, jo të plotë ose të pasaktë të publikuar, nëse cenon të drejtat ose interesat e saj/tij, në pajtim me ligjin.*

#### ***Neni 10 i Konventës [Liria e shprehjes]***



1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit audio, kinematografik ose televiziv.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

### **Argumentet e parashtruesve të kërkesës**

25. Përkitazi me nenin 37 të Kodit Penal, parashtruesit e kërkesës paraqitën këto argumente:

**Së pari**, ky nen, i cili futet te dispozitat e përgjithshme në Kodin Penal, në tërësinë e tij nuk specifikon se çfarë veprash penale mund të kryhen nëpërmjet medias, duke lënë kështu një hapësirë aq të madhe interpretimi, sa gazetarët nuk do të ndjeheshin komodë në ushtrimin e profesionit të tyre, e as të mbrojtur pas publikimit të informacioneve. Ky nen mundëson ngritjen e akuzave ndaj gazetarëve, redaktorëve, kryeredaktorëve, botuesve dhe shtypshkronjave për vepra të ndryshme penale.

**Së dyti**, neni 37 nuk e ka të përcaktuar çështjen e sanksionimit penal.

**Së treti**, neni 147, pika 1, 2, 3 dhe 4 i Kodit Penal, e adreson çështjen e kufizimit të lirisë së shprehjes dhe të medieve, përkatësisht adreson ndëshkimin për konsumimin e veprës penale që ka të bëjë me nxitjen ose me përhapjen publikisht të urrejtjes, të përçarjes ose të mosdurimit ndërmjet grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike, apo grupeve të tjera të tilla që jetojnë në Republikës e Kosovës. Pra, neni 37 është dublim i panevojshëm brenda të njëjtit ligj.

**Së katërti**, nenet 37, 38, dhe 39, parandalojnë publikimin e të gjitha informatave, përveç atyre që janë pozitive. Për këtë çështje, Gjykata Evropiane për të Drejta e Njeriut, e ka formuluar kështu qëndrimin e saj në vendimin "Hondyside vs Britanisë së Madhe": Liria e shprehjes është një nga shtyllat e shoqërisë demokratike, bazë për zhvillimin e saj dhe kusht për vetërealizimin e individit. Ajo nuk mund të përfshijë vetëm informacionet e perceptuara pozitivisht, ose të konsideruara si të padëmshme ose si indiferente, por edhe të tilla që fyejnë, turbullojnë, apo janë shqetësim për shtetin, apo për një grup të caktuar të shoqërisë. Të tilla janë kriteret e pluralizmit, të tolerancës dhe të hapjes, pa të cilat nuk mund të ekzistojë një shoqëri demokratike."

26. Përkitazi me nenin 38 të Kodit Penal, parashtruesit e kërkesës paraqitën këto argumente:

"Në pikën 2.1, të nenit 38, thuhet se zbulimi i informatave është i domosdoshëm për të parandaluar sulmin që përbën kërcënim të pashmangshëm ndaj jetës dhe ndaj integritetit trupor. Ky nen shkel nenin 40 dhe 42 të Kushtetutës së Kosovës, sepse

*nuk përcakton se ne çfarë momenti Gjykata mund ta detyrojë gazetarin të zbulojë informatën. Në fakt, ka vetëm një moment kur mund të ndodhë kjo, atëherë kur janë shteruar të gjitha mënyrat e tjera dhe ky është hap i domosdoshëm për të mbërritur tek ajo informatë dhe vetëm në raste shumë specifike.*

*Ruajtja e konfidencialitetit të burimit është esenciale për punën e gazetareve. Në rast se një instancë gjyqësore do t'i detyronte ata të tregonin burimin, sa herë që prokuroria apo policia nuk mbërrin vetë te kjo informatë apo burim, liria e medias do të cenohej rëndë dhe gazetarët nuk do të mund të kryenin misionin e tyre si observues të institucioneve demokratike, pasi vetë burimet nuk do t'iu besonin sepse ata do të ndiheshin të rrezikuar të zbuloheshin herët a vonë.*

*Pa një mbrojtje të tillë, burimet do të përmbaheshin nga informimi i shtypit për çështje të cilat kanë interes të madh për publikun. Si rezultat roli vital mbikëqyrës që ka media do të nënvlerësohej dhe mundësia që shtypi të provojë informacione të sakta dhe të besueshme do të zvogëlohej.*

*Ky Kod Penal ne tërësi nuk garanton as mbrojtjen e materialeve me të cilat punojnë gazetarët, që shpesh janë objekt i konfiskimeve nga ana e policisë.*

*Ndërsa Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut çështjen e mbrojtjes së burimeve e ka trajtuar në rastin e "Godwin vs Britanise së Madhe," në vendim thuhet : Mbrojtja e burimeve nga të cilat gazetarët përfitojnë informacione është një instrument i rëndësishëm, i cili i jep mundësisë shtypit të luajë rolin e rëndësishëm të vëzhguesit të shoqërisë demokratike, nëse gazetarët do të detyroheshin të zbuloheshin burimet, do të kishin shumë të vështirë për të arritur tek faktet, dhe si rezultat të informonin shoqërinë për çështjet me rëndësi publike. E drejta e lirisë së shprehjes e mbrojtur nga nenin 10 dhe e drejta që rezultojnë prej tij, e transmetimit dhe e marrjes së informacionit kërkon që deklarimi i burimit të ndodhë vetëm në rrethana mjaft të veçanta, psh kur këtë e kërkon interesi publik ose interesi i individit.*

*Si i tillë neni 38, nuk ofron garanci të mjaftueshme për mbrojtjen e informatave të gazetarëve, të burimeve dhe të materialeve të gazetarisë”.*

27. Në fund, përkitazi me nenin 39, parashtruesit e kërkesës dhanë këtë arsytim:

*“Ky nen lidhet me nenin 37 dhe 38. Në rast se Gjykata do të konstatojë shkeljen e nenit 40 dhe 42 të Kushtetutës, bie automatikisht”.*

### **Pranueshmëria e kërkesës**

28. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

29. Neni 113.1 i Kushtetutës thotë: “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

30. Përveç kësaj, neni 113.5 i Kushtetutës. parashikon që Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur”.

31. Kërkesa është parashtruar në Gjykatë brenda afatit kohor tetë ditë nga dita e miratimit të ligjit në Kuvend.
32. Prandaj, kërkesa është e pranueshme, pasi parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar, e kanë parashtruar kërkesën brenda afatit të përcaktuar dhe kësisoj i kanë respektuar kriteret e pranueshmërisë.

### **Vlerësimi i meritave të kërkesës**

33. Gjykata rikujton se, nenet e kontestuara 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal, u miratuan nga Kuvendi i Kosovës më 20 prill 2012 dhe u shpallën me vendim të Kuvendit më 22 qershor 2012.
34. Sidoqoftë, këto dispozita ishin objekt i një iniciative tjetër legjislative dhe i një debati në Kuvendin e Kosovës. Në të vërtetë, Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, i miratoi në lexim të parë projektamendamentet në Kodin Penal, Nr. 04/L-82, që parashikojnë heqjen e neneve 37, 38 dhe 39 nga Kodi i miratuar Penal.
35. Rregullorja e punës e Kuvendit të Kosovës e specifikon kështu miratimin e ligjeve:

#### **“Neni 56 Shqyrtimi i parë i një projektligji**

- 1. Shqyrtimi i parë i një projektligji nuk mund të bëhet pa kaluar dy javë pune dhe as më vonë se katër javë pune, nga dita e shpërndarjes së tij.*
- 2. Para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhje plenare, komisioni funksional - raportues, i ngarkuar nga Kryesia e Kuvendit, e shqyrton projektligjin në parim. Komisioni i paraqet Kuvendit raport me rekomandime për miratim ose për mosmiratim të projektligjit në parim.*
- 3. Shqyrtimi i parë i projektligjit nënkupton diskutimin dhe votimin e tij në parim.*
- 4. Shqyrtimi i parë fillon me paraqitje të përfaqësuesit të propozuesit të projektligjit, vazhdon me paraqitje të raportuesit të komisionit funksional, të përfaqësuesve të grupeve parlamentare dhe të deputetëve. Shqyrtimi mbyllet me votimin në parim.*
- 5. Propozuesi mund ta tërheqë projektligjin gjatë shqyrtimit në Kuvend, deri para fillimit të votimit në shqyrtimin e dytë.*

#### **Neni 57 Shqyrtimi i projektligjit në komisione**

- 1. Pas miratimit të projektligjit në shqyrtim të parë, Kuvendi i ngarkon për shqyrtim të mëtejshëm: Komisionin funksional, si komision raportues dhe komisionet: për Legjislacion dhe Gjyqësi, për Buxhet e Financa, për Integritet Evropian, për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione dhe për të Drejtat e Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, si komisione të përhershme.*
- 2. Në rastin kur projektligji rregullon çështje nga fushëveprimi i dy komisioneve funksionale, Kuvendi e ngarkon njërin prej tyre, si komision raportues.*



3. Amendamente në projektligj mund të parashtrojë deputeti, grupi parlamentar, komisioni parlamentar dhe Qeveria, në afat prej dy javësh pune nga miratimi në parim. Amendamentet i adresohen komisionit funksional - raportues.

4. Propozimi për amendamentin duhet të përmbajë: referimin ndaj dispozitës së projektligjit, formulimin e saktë të amendamentit dhe arsyetimin e ndryshimit të propozuar.

5. Propozimi i amendamenteve, që kanë implikime buxhetore, i dërgohet Komisionit për Buxhet dhe Financa, i cili duhet të deklarohet me raport, në afat prej pesë (5) ditëve pune, nga dita e pranimit

6. Komisioni funksional Kuvendit ia paraqet raportin me rekomandime për projektligjin brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë.

7. Në raste të veçanta, komisioni mund të kërkojë nga Kuvendi afat shtesë, deri në një muaj, për ta paraqitur raportin.

8. Komisionet e përhershme raportet e veta duhet t'ia paraqesin komisionit funksional, në afat prej dhjetë (10) ditë pune, nga dita e pranimit të amendamenteve nga komisioni funksional -raportues.

9. Komisioni funksional – raportues, pasi e përfundon shqyrtimin, Kuvendit i paraqet raport me rekomandime, së paku pesë (5) ditë pune para shqyrtimit të dytë në mbledhje plenare. Në raport përfshihet edhe mendimi i komisioneve të përhershme, si dhe deklarimi për amendamentet e propozuara nga deputeti, nga komisioni, nga grupi parlamentar apo nga Qeveria.

### **Neni 58** **Shqyrtimi i dytë i projektligjit**

1. Shqyrtimi i dytë i projektligjit fillon me paraqitjen e raportit të komisionit funksional nga raportuesi. Pas paraqitjes së raportit, të drejtën e diskutimit e kanë përfaqësuesit e komisioneve të përhershme, përfaqësuesit e grupeve parlamentare, përfaqësuesit e Qeverisë dhe deputetët.

2. Shqyrtimi i dytë i projektligjit vazhdon me shqyrtimin dhe me votimin e amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional – raportues dhe të amendamenteve të propozuara nga komisionet e tjera, nga grupet parlamentare, nga Qeveria dhe nga deputetët.

3. Amendamentet shqyrtohen dhe votohen një nga një, sipas radhitjes së paraqitur, krahas tekstit të projektligjit.

4. Kur janë të propozuara dy amendamente për të njëjtin nen të projektligjit, që e përjashtojnë njëri-tjetrin, amendamenti i cili merr numrin më të madh të votave, konsiderohet i miratuar.

5. Pas shqyrtimit dhe miratimit të amendamenteve, të pasqyruara në tabelën krahasuese me tri kolona (teksti i projektligjit, i amendamenteve dhe teksti përfundimtar), votohet teksti i Projektligjit në tërësi me ndryshimet e miratuara.

**Neni 59**  
**Shqyrtimi i tretë i projektligjit**

- 1. Kur projektligji në shqyrtimin e dytë nuk merr numrin e duhur të votave për miratim, me kërkesë të propozuesit të projektligjit ose të komisionit funksional, Kuvendi vendos që projektligjin ta paraqesë edhe në shqyrtimin e tretë, së bashku me amendamentet e miratuara.*
  - 2. Amendamentet që janë shqyrtuar dhe që janë refuzuar në shqyrtimin e dytë, ose që janë të ngjashme me amendamentet në shqyrtimin e dytë, nuk mund të propozohen për shqyrtimin e tretë.*
  - 3. Procedura e shqyrtimit të amendamenteve plotësuese dhe procedura e shqyrtimit të projektligjit të ndryshuar në leximin e tretë, duhet të jenë në pajtim me nenin 58 të kësaj Rregullore”.*
36. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se një proces legjislativ është në zhvillim e sipër në Kuvend për heqjen e neneve të kontestuara 37, 38 dhe 39 të Kodit të miratuar Penal.
  37. Përmbyllja e këtij procesi legjislativ është relevante dhe ka ndikim në objektin e çështjes së ngritur nga parashtruesit në këtë kërkesë.
  38. Në këtë fazë, edhe pse rishtazi është arritur progres, ende nuk është e mundur të parashikohet në mënyrë të arsyeshme se kur do të finalizohet përfundimisht ky proces.
  39. Prandaj, duke marrë parasysh datën e lartpërmendur (1 janar 2013), Gjykata konsideron se është shumë e parakohshme të vlerësojë dhe të vendosë për meritat e kërkesës.

## **PËR KËTO ARSYE**

Në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës, në pajtim me nenet 20, 42 dhe 43 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata Kushtetuese, njëzëri:

### **VENDOSI**

- I. TË SHPALLË kërkesën të PRANUESHME;
- II. TË SHTYJË vendimin për meritat e kërkesës deri më 15 dhjetor 2012 dhe të mbetet e përkushtuar ndaj këtij rasti;
- III. TË KËRKOJË nga Kuvendi i Kosovës që ta informojë Gjykatën në afatin kohor pesëmbëdhjetë (15) ditë për statusin e procedurës legislative përkitazi me heqjen e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82;
- IV. T' UA KOMUNIKOJË këtë vendim palëve dhe ta botojë në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,
- V. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues

Prof. dr. Enver Hasani

